

INSTRUKSION ADMINISTRATIV NR. 2002/03

PËR RISHIKIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT DHE ÇERTIFIKIMIT TË AUDITORËVE DHE PROCEDURA E ÇERTIFIKIMIT TË KONTABILISTËVE

Bordi i Kosovës mbi Standardet për Raportim Financiar,

Duke marrë në konsiderim Regulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/30 “Mbi Vendosjen e Standardeve për Raportim Financiar” dhe Regjimin për Raportim Financiar të Organizatave të Biznesit, (në tesktin e mëtejme “Regullorja”), për qëllim të vendosjes së procedurave për licensimin e firmave të huaja të auditimit në Kosovë.

Nëpërmjet kësaj shpall sa vijon:

Neni 1 Autoriteti i Bordit

Autoriteti i Bordit për vendosjen e procedurave për rishikimin e licensimit dhe çertifikimit të auditorëve dhe çertifikimit të kontabilistëve është vendosur në nenin 7 të Regullores.

Neni 2 Rishikimi periodik

Bordi do të filloj një rishikim të procedurave të licensimit dhe çertifikimit të auditorëve dhe çertifikimit të kontabilistëve çdo tre vjet prej datës së hyrjes në fuqi të Regullores.

Neni 3 Paneli ndërkombëtar për rishikim

3.1 Një panel prej anëtarëve jo kosovar do të zgjedhet nga ana e Bordit me qëllim të drejtimit të procedurave për rishikim të licensimit dhe çertifikimit të auditorëve dhe të çertifikimit të kontabilistëve (“Paneli për rishikim”).

3.2 Anëtarët e panelit për rishikim duhet të kenë përvojë të mjaftueshme me procedura të licensimit dhe çertifikimit dhe me praktika të ekzaminimit për të administruar një rishikim adekuat; të jenë auditorë të licensuar/çertifikuar nga shtetet tjera të cilat kanë edukim, ekzaminim dhe përvojë të ngjashme me ato të cekura në nenin 7 të Regullores.

Së paku njëri nga anëtarët e panelit për rishikim do të jetë i licensuar ose certifikuar në një shtet i cili është anëtarë i plotë i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve.

3.3 Të gjitha aplikacionet, vendimet, konsideratat, provesverbalet e takimit, regullat procedurale dhe informatat tjera të cilat paneli për rishikim mund t'i kërkoj duhet t'i vihen në dispozicion panelit për rishikim për të mundësuar shqyrtimin.

3.4 Bordi do t'i vejë në dispozicion para panelit çfarëdo përkthime të cilat nevojiten në mënyrë të arsyeshme për të asistuar panelin në kriteret dhe procedurat e tij për licensimin dhe certifikimin e auditorëve dhe certifikimin e kontabilistëve.

3.5 Paneli për rishikim do t'i rishikoj procedurat dhe kriteret për certifikim dhe licensim të auditorëve dhe certifikim të kontabilistëve dhe do të bëjë rekomandime lidhur me ndryshime dhe modifikime të cilat duhet të bëhen.

Neni 4

Raporti i panelit për rishikim

4.1 Paneli për rishikim duhet ti siguroj një raport Bordit brenda gjashtë javësh nga kompletimi i rishikimit. Raporti do të publikohet në veb faqen e Bordit në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

4.2 Bordi do të përgjigjet brenda gjashtë javësh prej pranimit të raportit të panelit për rishikim. Përgjigjja e Bordit do të publikohet në veb faqen e Bordit në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, dhe do të tregoj se çfarë veprime do të ndërmerren, nëse ndonjë, për të implementuar rekomandimet e cekura në raportin e panelit për rishikim.

4.3 Përgjigjja e Bordit duhet të cek fushta në të cilat rekomandimet e panelit për rishikim nuk janë pranuar, duke specifikuar arsyet për secilën fushë të papranuar.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky Instruksion Administrativ hyn në fuqi menjëherë pas lëshimit.

Mustafë Ibrahim, Kryesues

Prishtinë
13 Mars 2002